



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2177/ 2 prot.,

Datë 07.09.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri” SHPK & “SMO Union” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-74269-07-04-2023, me objekt: “Ndërhyrje në infrastrukturë rrugore Faza II”, me fond limit 500.000.000 (pesëqind milion) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 24.07.2023 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
- Ankimues:** Bashkimi i operatorëve ekonomik “Curri” SHPK & “SMO Union”, me NIPT (J67902718S), me adresa: Rruga “Kajo Karafili”, Nd. 2, H. 4, Ap. 3, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
Adresa: Rruga “Sami Frashëri”, nr. 10, Tiranë

Në datën 06.09.2023 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër elektronik A/2023/3397, dhe me numër 2177/2023 datë 06.09.2023 e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Curri” SHPK & “SMO Union” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-74269-07-04-2023, me objekt: “Ndërhyrje në infrastrukturë rrugore Faza II”, me fond limit 500.000.000 (pesëqind milion) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 24.07.2023 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Curri” SHPK & “SMO Union” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Curri” SHPK & “SMO Union” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 2177/2023 prot., datë 06.09.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

Bashkimi i operatoreve ekonomik “SMO Union” shp.k & “Curri” sh.p.k nuk ploteson Kriterin per kapacitetin teknik pika 2.3.1. te Krieteve te vecante ne DT per objektin Ndërhyrje në infrastrukturë rrugore Faza II “ per sa i perket "Përvojës së suksesshme ne realizimin e puneve te ngjashme” a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së për llogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar nga operatori ekonomik gjatë pese vitet të fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates ose b) Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pese viteve të fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Konkretisht, anetaret pjesemarres te bashkimit te operatoreve “SMO Union” shp.k & “Curri” shp.k nuk plotesojne kriterin per pune te ngjashme ne vlere sipas perqindjes (%) se marre persiper ne kete bashkim.

Në bazë të përcaktimeve të legjislacionit për prokurimin publik, të parashikuara edhe në dokumentat e tenderit, bazuar edhe në konceptin e pergjithshëm të prokurimeve, objektet/ kontratat e ngjashme që të mund të konsiderohen të tilla duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative elementin e kohës, vlerës dhe natyrës së ngjashme. Pra, (i) objekti i përfunduar i kontratës duhet të jenë brenda afatit (elementi kohë), (ii) duhet të plotësojnë madhësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor, 50% apo 200% (elementi vlerë) dhe (iii) duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme). Mungesa qoftë edhe një prej ketyre elementëve e bën të pavlefshëm eksperiencën e ngjashme të paraqitur nga kandidati ofertues.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 07.09.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Nënkryetar
Fiorent Zguro**